# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-445960**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama uron Kurtin për mandatin e ri qeverisës: Të vazhdojmë bashkëpunimin në të gjitha fushat për të përshpejtuar rrugëtimin drejt BE-së - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/rama-uron-kurtin-per-mandatin-e-ri-qeverises-te-vazhdojme-bashkepunimin-ne-te-gjitha-fushat` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 12:16:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 12:13:06 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `98cf98e0915ccfb7959b736325e44c53817721295e4a5c87132f7868bbae868b` |
| TEKSTI | `760b122e6e730af1b1a3a73de6b6519c678a35af94d59effe00d20d2e53d3a9c` |
| PAMJA | `55f01dfa4b9692593a943ab22b3b35f422eca9260470df614576d6be083b50b7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4aa030a5fc76b0175bed4a2360bb61f10372347f0093414e49fa115287de0c4c` |
| E MËPARSHMJA | `e40d0a610d1e27454eb2ff472f9f226bd586205441c5679dd90ab0a48d5fb0fe` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4aa030a5fc76b0175bed4a2360bb61f10372347f0093414e49fa115287de0c4c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





# Rama uron Kurtin për mandatin e ri qeverisës: Të vazhdojmë bashkëpunimin në të gjitha fushat për të përshpejtuar rrugëtimin drejt BE-së

*Kryeministri Edi Rama ka uruar Albin Kurtin për mandatin e ri qeverisës. Kreu i qeverisë ka theksuar vijimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kosovës në të gjitha fushat. Edi Rama ka ftuar, Kurtin për një vizitë në vendin tonë.*



*Albin Kurti*




Redaksia
15 Shtator, 14:04 | **Përditesimi: 15 Shtator, 14:25**

Share Tweet

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pranoi letër urimi për mandatin e ri qeverisës nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Sipas mediave në Kosovë kreu i qeverisë ka theksuar se Shqipëria mbetet e gatshme për bashkëpunim të gjithanshëm me Kosovën, në të gjitha nivelet dhe fushat, me synimin për të përshpejtuar rrugëtimin drejt integrimit evropian.

Rama ka përmendur gjithashtu zbatimin e marrëveshjeve të miratuara mes dy vendeve, si dhe shqyrtimin e projekteve të reja në sektorët prioritarë. Sipas tij, këto angazhime janë në dobi të qytetarëve të të dyja vendeve dhe synojnë përmirësimin e mëtejshëm të jetës së tyre. Ndërkohë raportohet se kryeministri Edi Rama ka ftuar, Kurtin për një vizitë në vendin tonë.

> *"Mandati juaj i ri qeverisës më ofron rastin e duhur t'ju përcjell urimet e mia më të përzemërta për sukses. Gjithashtu, e shfrytëzoj këtë mundësi për të riafirmuar gatishmërinë time dhe të qeverisë që unë drejtoj, për një bashkëpunim të gjithanshëm, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat, për të përshpejtuar hapat në rrugëtimin tonë sfidues drejtë shtëpisë së përbashkët evropiane. Zbatimi sa më i plotë i marrëveshjeve të miratuara dhe shqyrtimi e angazhimi në projekte të reja, nga sektorët më të rëndësishëm e prioritarë, janë në dobi dhe do të përmirësojnë e pasurojnë më tej jetën e qytetarëve tanë", shkroi mes tjerash kryeministri Rama.*



LEXO EDHE:
***Ylli Pata: Flamingot çfarë janë sot, lëvizje apo revolucion?***

Kuvendi i Kosovës u shpall i konstituuar të dielën paradite, pasi u zgjodhën nënkryetarët nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe komuniteteve pakicë. Kryetarja dhe nënkryetari i parë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në pushtet ishin zgjedhur në seanca të mëparshme të mërkurën dhe premten, përkatësisht.

PDK-ja nuk mori pjesë në seancë dhe paraprakisht e kishte tërhequr kandidaturën e Vlora Çitakut për nënkryetare, kur LVV-ja nuk ia kishte votuar në seancën e të premtes. LVV deklaroi të shtunën se do ta votonte Çitakun. Por, PDK nuk pranoi të merrte pjesë.

Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se Kuvendi "nuk mund të mbetet peng i askujt, i asnjë subjekti politik", dhe e vazhdoi procesin. Pas votimit të nënkryetarëve, Haxhiu deklaroi se Kuvendi "konsiderohet i konstituuar". Disa orë më vonë, Kuvendi u mblodh sërish dhe e zgjodhi Qeverinë e re, në një seancë të braktisur nga PDK, Aleanca dhe LDK.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Kuvendi i kosoves | kosove | Albin Kurti | edi rama | integrimi ne be

Sa e vlerësoni këtë artikull?

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

Sondazhi i ditës:

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



Rama nis vizitën në SHBA me një takim me komunitetin shqiptar në Michigan: Ftoj çdo bashkëkombas të na bashkohet!

20 Shtator, 20:03



Protestat/ Rama për gazetën gjermane: Shqipëria nuk shitet! Nuk ndihem i kërcënuar, protestat janë pjesë e demokracisë

20 Shtator, 17:20



Shqipëria në Asamblenë e OKB-së, Hoxha: Angazhim të palëkundur për reforma dhe progres, Rama: Rruga drejt BE-së kalon nga Agjenda 2030

20 Shtator, 16:35



Verdikti i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?

20 Shtator, 13:40



Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet në Morinë 34-vjeçari nga Kosova (EMRI)

20 Shtator, 11:31



Rama propozon partneritet me komunitetet lokale në zonat turistike: Do të krijojmë një fond për shoqatat që mbrojnë territorin (VIDEO)

20 Shtator, 10:09



Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe



Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?



Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52

19 Shtator, 21:58

19 Shtator, 21:43



**Komiteti i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri mblidhet në 21 dhe 22 shtator**

19 Shtator, 19:04



**Adri Nurellari: Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi, çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën**



Adri Nurellari

19 Shtator, 18:58



**Kosovë/ Hamza viziton familjet Thaçi, Veseli dhe Krasniqi: Do të vazhdojmë betejën për drejtësi deri në kthimin në atdhe të luftëtarit të fundit të lirisë**

19 Shtator, 18:49

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.